



Prishtinë: 05.11.2008

Kodi i ZRRE-së: V\_126\_2008

Nr. i referencës: ZRRE/DMK\_V\_126\_10\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK-së në ZRRE: ZRRE/DMK\_V\_126\_10\_08 të datës 10.10.2008;
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 23.10.2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur me datë 04 nëntor 2008 nxori këtë:

### VENDIM

**Pjesërisht PRANOHET** apelimi i konsumatorit Fazli Haziri, (shifra e konsumatorit DPR – 49527) nga Albana e Madhe, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

### Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Bordit të ZRRE-së ka apeluar vendimin DMK të ZRRE-së nr. **ZRRE/DMK\_V\_126\_10\_08 (I bashkangjitur)**.
2. Me analizimin e arsyetimit të paraqitur në vendimin e DMK-së dhe proceseve të paraqitura nga pala dhe KEK-u, është vërejtur një lëshim procedural në këtë rast:
  - Në procesin e kontrollit të ekipit të KEK-ut nr. 0104976 të datës 04.01.2008, është theksuar se blloba distribuive është në rregull, që do të thotë se punëtorët e KEK-ut me rastin e vendosjes së bllobes nuk e kanë verifikuar gjendjen teknike të njehsorit. Pastaj ekipi i kontrollit me datë 04.01.2008 ka gjetur se njehsori i ka pas të larguara urat në fazën “S” dhe “T”, edhe pse njehsori ka qenë i bllobuar me bllobë distribuive.



3. Me analizimi e konsumit të konsumatorit shihet se konsumi i tij ka rënë dukshëm në vitin 2007, krahasuar me vitin paraprak 2006 dhe atë vijues 2008, e kjo përputhet me konstatimin e ekipit të kontrollit të KEK-ut se dy ura të njehsorit kanë qenë të larguara, andaj njehsori ka regjistruar vetëm 1/3 e energjisë së konsumuar.

Bordi i ZRRE-së duke marrë parasysh arsyetimin e paraqitur në vendimin e DMK-së sipas pikës 1, lëshimet procedurale të KEK-ut sipas pikës 2, konsumin e regjistruar të konsumatorit sipas pikës 3, dhe duke marrë parasysh se fillimi i konsumit të paautorizuar (largimi i urave) nuk mund të caktohet me saktësi; vendosi që **pjesërisht ta pranojë** ankesën e konsumatorit duke mos e liruar atë nga përgjegjësia për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë, por që llogaritja e konsumit të paautorizuar të bëhet vetëm për **6 muaj** nga data kur ekipi i kontrollit ka bërë kontrollimin e pikës matëse.

Sipas këtij Vendimi obligohet KEK-u që ta shkarkoi konsumatorin nga fatura DPR08HP04387, dhe ta ngarkoi konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar sipas këtij vendimi, për 6 muaj.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare